



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.791/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të masës së sigurimit M.M.K. shtetas i Republikës së Polonisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Arber Guta avokat nga Prishtina kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit K.V. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Emin Zariqi avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.90/24 datës 29.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit M.M.K. shtetas i Republikës së Polonisë, dhe ankesa e kundërshtarit të sigurimit K.V. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale -Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.90/24 i datës 29.02.2024, VËRTETOHET

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.90/24 i datës 29.02.2024, ka vendosur si në vijim: I Aprovohet pjesërisht si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit M.M.K., Caktohet masa e sigurimit ashtu që i ndalohet kundërshtarit të sigurimit K.V., të kryej çfarëdo aktiviteti në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar VPMG me seli në Prishtinë, II Refuzohet pjesërisht si i pabazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit M.M.K. i paraqitur ndaj kundërshtarit të sigurimit K.V. me të cilën ka kërkuar që të autorizohet propozuesi i masës së sigurimit M.M.K., që deri në vendimin tjetër të gjykatës të ushtroj të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Drejtorit Menaxhues në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar VPMG.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë kanë paraqitur i autorizuari i propozuesit të masës së sigurimit Granit Vokshi avokat nga Prishtina dhe i autorizuari i kundërshtarit të masës së sigurimit Emin Zariqi avokat në Prishtinë

Në ankesën e tij i autorizuari i propozuesit të masës së sigurimit Granit Vokshi avokat nga Prishtina deklaroi se duke pasur paarsysh faktin se masa e sigurisë bazohet në zbatimin e vendimit të ligjshëm të Kuvendit të aksionarëve dhe se kushtet nga LPK për caktimin e masës së sigurisë, siq është vlersuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, propozuesi i sigurimit kërkon nga Dhoma e shkallës së dytë që të nxjerr vendim me të cilin aprovet në tërsi si e themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit, të Ndryshohet aktvendimi KE.nr.90/24 i datës 29.02.24, ashtu që të Aprovet në tërsi si i bazuar propozimi i masës së sigurimit M.M.K., Caktohet masa e sigurimit ashtu që i ndalohet kundërshtarit të sigurimit K.V. që të kryej qfarëdo aktiviteti në cilësinë e Drejtorit Menaxhues të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar VPMG dhe Obligohet kundërshtari i sigurimit K.V. që të zbatoj vendimin e Kuvendit të aksionarëve për ndryshimin e Drejtorit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar VPMG.

I autorizuari i kundërshtarit të sigurimit Emin Zeqiri avokat në Prishtinë, me ankesë kundërshtoi aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore të LPK-së dhe LKA-së dhe konstatimit jo të drejtë të gjendjes faktike, me propozimin që të Aprovet si e bazuar ankesa e kundërshtarit të sigurimit K.V. nga Prishtina, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale -Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.90/24 i datës 29.02.2024, dhe lënda i kthehet Dhomës së shkallës së parë, në rishqyrim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pa pathemelta

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit M.M.K., përmes të autorizuarit të tij, me datën 31.01.2024, pranë gjykatës ka ushtruar padi me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit K.V. nga Prishtina, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, ashtu që të i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të kryej qfardo aktiviteti në cilësinë e drejtorit menaxhues në shoqëri dhe të autorizohet propozuesi i masës së sigurimit M.M.K., që deri në vendimin tjetër të kësaj gjykate të ushtroj të gjitha të drejtat dhe detyrimet e drejtorit menaxhues.

Dhoma e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 21.02.2024, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe ka marrë Aktvendimin e atakuar KE.nr.90/24 datës 29.02.2024, me të cilin ka Aprovet pjesërisht si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të këtij vendimi Dhoma e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet ligjore nga neni 297.1 të LPK-së, dhe vendimin e ka mbështet në provat e lëndës, respektivisht vendimin e datës 02.05.2023 i nxjerr nga Kuvendi i aksionarëve të shoqërisë VPMG shpk, që me shumicë votash dhe në përputhje me statutin e shoqërisë, si dhe dispozita ligjore nga neni 102 pika 2.9 e lidhur me nenin 105 pika 1.2 të LSHT, ka emëruar Drejtorin e ri

menaxhues të shpk, ndërsa është shkarkuar nga kjo pozitë kundërshtari i masës së sigurimit. Në arsyetim më tej theksohet se gjykata vlerëson se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të shkactohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohej, nga shkakut se me ndërmarrjen eventuale të veprimeve në cilësinë e drejtorit menaxhues nga ana e kundërshtarit të sigurimit, edhe pse i njëjti është shkarkuar, propozuesit të sigurimit do të shkactohej dëm vështirë i riparueshëm dhe rrjedhimisht të rrezikohej kapitali i investuar në shoqëri. Ndërsa gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, pasi që autorizimi për të ushtruar të drejtat dhe detyrat e drejtorit menaxhues është kompetencë ekskluzive e kuvendit të aksionarve në shpk, dhe rrjedhimisht gjykata nuk ka tagër për të dhënë personave brenda shoqërisë autorizime të tilla.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave ligjore sikurse pretendohet në ankesë, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqet Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i vlerësoi në baza ligjore ankesat e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe të njëjtat nuk i vlerësoi si të bazuara për ta ndryshuar një gjendje tjetër të konstatuar nga dhoma e shkallës së parë. Kolegji vlerëson se me të drejtë Dhoma e shkallës së parë është referuar në dispozitat e nenit 102 pika 2.9 të Ligjit 06/L-016 për Shoqërit Tregtare, që përcaktojnë kompetencat e kuvendit të aksionarve, të marrë vendim për të zgjedhur dhe shkarkuar personin që mban pozitën e Drejtorit Menaxhues. Në vështrim të kësaj dispozite ligjore, Kolegji vlerësoi se në rastin konkret Dhoma e shkallës së parë, me të drejtë ka aplikuar nenin 297.1 pika (b) të LPK-së, se në rastin konkret ekziston rreziku se kundërshtari i sigurimit i shkarkuar tanimë me vendimin e datës 02.05.2023 nga Kuvendi i aksionarve të shoqërisë VPMG, i njëjti mund të shkaktojë dëm të riparueshëm në këtë pozitë, ku do të rrezikohej afarizmi i shoqërisë.

Kolegji nuk i vlerësoi të drejta pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurimit se me aprovimin e pjesërisht të masës së sigurisë, Kompania ka mbetur pa Drejtor Menaxhues dhe si i tillë mund të kufizohet në zhvillimin e veprimtarisë afariste. Në këtë rast Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit, ka bërë me dije palëve se ligjvënisi (neni 102 pika 2.9 e Ligjit), i ka dhënë të drejtë vetëm Kuvendit të aksionarve shpk, të emrojë dhe shkarkojë Drejtorin Menaxhues në SHPK, prandaj janë të papranueshme pretendimet se Shoqëria VPMG, ka mbetur pa drejtor menaxhues, duke pasur parasysh se paraprakisht organi më i lartë vendimarrës në shpk VPMG-Kuvendi i aksionarve, ka miratuar një vendim datës 02.05.2023 me të cilin ka emruar menaxherin e ri të shoqërisë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të kundërshtarit të sigurimit se aktvendimi i atakuar është kontradiktore nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike duke iu referuar provave në shkresat e lëndës që janë në kundërshtim njëra me tjetrën, se është në kundërshtim me statutin vendimi i datës 02.05.2023. Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së

Dytë, këto pretendime nuk janë të bazuara, sepse vendimi i atakuar i Dhomës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 të LPK-së, e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë, propozuesit (i emruar Drejtor i ri menaxhues nga SHPK), do të mund ti shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm, dhe do të rrezikohej kapitali i investuar në shoqëri, nga aksionari-kundërshtari i sigurimit, i cili është shkarkuar tani më nga pozita e Drejtorit Menaxhues nga organi kompetent i SHPK-së, andaj në këtë drejtim Dhoma e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht propozimin për caktimin e masës së sigurimit sikurse në dispozitiv të aktvendimit. Pretendimi se vendimi i datës 02.05.2023 është në kundërshtim me statutin e SHPK, kjo gjykate nuk ka mund ta pranoj një pretendim të tillë që do të gjente mbështetje ligjore.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e dhomës së shkallës së parë, pasi që i ka vlerësuar vetëm rrethanat dhe veprimet nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit të sigurimit, do të mund të shkaktohej dëm i riparueshëm në ushtrimin e aktivitetit afarist, nga aksionari i shkarkuar nga pozita e Drejtorit Menaxhues në SHPK VPMG.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.791/24 i datës 04.04.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Krenar Berisha